



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:002546
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06658358

APS.nr.50/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti Special në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Kreshnik Radoniqi - Kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Burim Ademi - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.M, për shkak të veprës penale Kanosja, nga neni 181 paragrafi 2 të Kodit *Nr.06/L-074* Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.M, av. A.K, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.49/24 të datës 26.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 26.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.M, av. A.K, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.49/24 i datës 26.08.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.49/24 të datës 26.08.2024, i akuzuari B.M është shpallur fajtor për veprën penale, Kanosja, nga neni 181 paragrafi 2 të KPPRK-së dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj. Konform nenit 44 paragrafi 1 të KPPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit pas shpalljes së aktgjyqimit dënimi i shqiptuar me burgim i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej

katër mijë e pesëqind (4,500.00) Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 90 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi të ankimuar. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguaj në afatin e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë, atëherë gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë me burg do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 100€ (njëqind euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 100.00€ (njëqind euro), e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Për shpenzimet tjera eventuale, gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të gjykatës.

E dëmtuara A.H.C, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë:

Mbrojtësi i të akuzuarit B.M av. A.K, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjukata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim me gjobë më i ulët.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti Special me propozim që të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës në Prishtinë me shkresat PPA/I.nr.566/2024 të datës 28.10.2024 dhe 18.12.2024, ka propozuar të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.M av. A.K e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS.nr.49/2024 të datës 26.08.2024 dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet ndërsa të aprovohet si e bazuar përgjigja në ankesë e prokurorit të shtetit.

Gjukata e Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPP-së nuk njoftoi palët për seancë, meqenëse në këtë çështje penale është shqiptuar dënimi me gjobë dhe nuk ka pretendime për shqyrtimin e fakteve dhe ligjit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, andaj kolegji e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK,

vlerësoi pretendimet ankimore e mbrojtësit e të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: **Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore

Mbrojtësi i të akuzuarit B.M av. A.K, në ankesë thekson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shndërrimit të dënimit me burgim prej 6 (gashtë) muajve me dënim me gjobë në shumë prej 4,500.00 Euro. Mbrojtja konsideron se gjykata nuk e ka caktuar në mënyrë të drejtë dënimin me gjobë, pasi që ajo, përkundër asaj se në arsyetimin e aktgjykimit të goditur me këtë ankesë e cek se me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuar sipas nenit 70 të KPRK-së, e njëjta nuk e ka aplikuar si duhet këtë dispozita ligjore pasi që dënimi i shqiptuar me gjobë është shumë i lartë, në raport me veprën penale, si dhe faktit të pranimit të fajësisë. Për më tepër Gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese në arsyetimin e këtij aktgjykimi ka marrë për bazë faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajit që nga momenti i parë në procedurë penale, e po ashtu në gjykatë, keqardhjen që i njëjti e ka shfaqur lidhur me rastin dhe kërkim faljen ndaj tani të dëmtuarit. Po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin B.M ka marrë edhe faktin si i njëjti ka një të kaluar të pastër, si dhe faktin se i akuzuari B.M ka bashkëpunuar me organet e rendit të Republikës së Kosovës, pasi që i njëjti edhe pse jeton jashtë vendit vullnetarisht i është paraqitur edhe prokurorisë edhe gjykatës me qëllim që të gjykohet lidhur me veprimet e tija. Si rrethanë rënduese, në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka gjetur faktin se është kanosur një gazetare lidhur me punën dhe raportimin e saj, e mbi këtë rrethanë gjykata shqiptoj një dënim shumë më të ashpër se sa në raste të tjera në raport me praktikën gjyqësore të sanksioneve penale përkitazi me vepër penale të kanosjes, kur ato janë të sanksionuara nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-së. Prandaj duke u marrë për bazë se me rastin e matjes së lartësisë së dënimit me gjobë Gjykata ka anashkaluar edhe praktikën gjyqësore të sanksioneve penale përkitazi me vepër penale të kanosjes, kur ato janë të sanksionuara nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-së, dhe të pandehurit B.M i shqipton gjobën në shumë prej 4.500.00 Euro, e që sipas mbrojtjes kjo gjobë nuk është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimit të dënimit të shqiptuar. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, është dashur që të bazohet edhe në faktin se i pandehuri është mbajtës i vetëm i familjes 6 anëtareshë, dhe se puna e tij si punëtor fizik në lëmin e ndërtimtarisë në shtetin e Gjermanisë nuk i sjell të ardhura të mjaftueshme për ta mbajtur familjen e tij, duke e marrë parasysh tani edhe

faktin e ditur botërisht se në çfarë periudhë të vështirë ekonomike e sociale po kalojnë vendet e kontinentit tonë, si dhe të marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese të cekura më lartë. Mbrojtja konsideron se shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit do të mund të arrihej edhe me shqiptimin e një gjobe më të ulët, e cila do të ishte në harmoni me përlllogaritjen e përcaktuar me nenin 43 paragrafi 3 të KPKRK-së. Nga të lartcekurat mbrojtja ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë të akuzuarit B.M t'ia zbut dënimin e shqiptuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur Prokuroria Speciale ku ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në ankesë për faktin se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë kur të akuzuarin B.M e ka shpallur fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe se me rastin e marrjes së aktgjykimit ka vendosur në përputhje me dispozitat e KPPK-së.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Edhe pse me ankesë aktgjykimi i ankimuar nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare, konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, apo shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesën e mbrojtësit nuk kontestohet as gjendja faktike në këtë çështje penale prandaj, as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, e që në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore konform nenit 383 par.2 të KPP-së, ngase i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale për të cilën gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit përkitazi me vendimin për sanksion penal.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit B.M, av. A.K, për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 70 të KPRK-së ashtu që për të pandehurin B.M, si rrethana lehtësuese gjeti, pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit nga momenti i parë në procedurë penale e po ashtu në gjykatë, keqardhjen që i njëjti e ka shfaqur lidhur me rastin dhe kërkim faljen ndaj tani të dëmtuarës. Si rrethanë lehtësuese, gjykata e shkallës së parë mori për bazë edhe faktin se tani i akuzuari ka një të kaluar të pastër pasi që nga shkresat e lëndës të indicieve të tij të përpiluara nga Policia e Kosovës rezulton fakti se i njëjti madje nuk ka qenë as edhe njëherë i dyshuar për ndonjë veprë penale dhe se ky ishte rasti i tij i parë. Si rrethanë lehtësuese, gjykata e shkallës së parë mori për bazë edhe bashkëpunimin e tani të akuzuarit me organet e rendit pasi që i njëjti edhe pse jeton jashtë vendit vullnetarisht i është paraqitur edhe prokurorisë edhe gjykatës me qëllim që të gjykohet lidhur me veprimet e tija. Si rrethanë veçanërisht rënduese, gjykata e shkallës së parë mori për bazë faktin se është kanosur një gazetarë lidhur me punën dhe raportimin e saj. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet si në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.M av. A.K, për shqiptimin e një dënimi me gjobë më të butë, me pretendim se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, janë pretendime të pabazuara dhe si të tilla janë të përgjithësuara duke mos potencuar asnjë rrethanë tjetër apo të re pas shqiptimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë e të cilën e njëjta nuk e morri parasysh gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, që si të tilla kishin për të ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër të dënimit nga ai i shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar, andaj kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se më të do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit

38 të KPK-së, që të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.50/2024 më datë.26.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Gresë Latifi

Anëtarët e kolegjit
Vaton Durguti

Kryetari i kolegjit,
Kreshnik Radoniqi

Burim Ademi
